

Nacionale

redaktor: Ilir Mirena • e-mail: ilir.mirena@gazetaexpress.com
tel: 038 76 76 76 fax: 038 76 76 78

Problem me hapësirat publike

Prishtinë, 4 tetor - Partia e Drejtësisë ka ngritur shqetësimet e saja për keqmenaxhimin e hapësirave publike dhe i ka bërë thirrje Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të menaxhojë urgjentisht këtë çështje, në të kundërtën ka tërhequr vërejtjen se problemi i kaosit urbanistik do të thellohet

edhe më shumë. Në një konferencë për media, anëtari i kryesisë së PD-së, Ylli Shaqiri, tha se keqmenaxhimi i hapësirave publike është rezultat i paaftësisë së autoriteteve qendrore dhe lokale, për çka ka shprehur shqetësim edhe një delegacion holandez i Institucionit të Planifikimit Urban gjatë një vizite

të mëhershme në Kosovë. Partia e Drejtësisë me këtë rast i rekomandon Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të menaxhojë në mënyrë urgjente problemin e kaosit urbanistik dhe keqmenaxhimit të hapësirave publike, e cila do të ishte në interes jetik për qytetarët.

NJE SHANS I DYTE

Endrit Zhushi, 4 vjeç nga fshati Svegël, i cili po vuante nga një sëmundje në zemër, është kthyer shëndosh e mirë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Endriti së bashku me nënën e tij janë dërguar në SHBA përmes programit Dhurata e Jetës të organizatës Rotary International. Operacioni ka kushtuar 250 mijë dollarë.

MetroWest Daily News

NATRICK, 4 TETOR —

Vetëm dhjetë ditë pas operimit të zemrës në Spitalin e Fëmijëve në Boston, katërvjeçari energjik vraponte përreth oborrit duke luajtur me topin e tij.

Në kërkim të operacionit shpëtues, i cili nuk mund të bëhej në vendin e tyre, fëmija më i vogël i familjes, Endrit Zhushi dhe nëna e tij, Behrija kanë udhëtuar për në Boston nga një fshat i vogël i Kosovës i quajtur Svegël.

Ata janë dërguar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes programit Dhurata e Jetës të organizatës Rotary International. Më pas ata janë mirëpritur në shtëpi nga kryetarja e kaluar e Rotary Club në Natick, Gerard, burri i saj Marc Peloquin dhe vajza e tyre, Dani.

Endriti, i cili kishte pasur një vrimë në zemër, nuk do të mund të jetonte më shumë se dymbëdhjetë vjet. Mirëpo, më 13 shtator, dr. Frank Pigula kreu me sukses operacionin në zemrën e 4-vjeçarit.

“Përmirësimi i Endritit është i pabesueshëm. Ai po bën për mrekulli. I vetmi problem është që ai dëshiron ta kruajë plagën e tij”, thotë nëna e tij, Behrija.

Përkthyesi i saj, Toni Rukaj thotë se Behrijes i është dashur një kohë



Endrit Zhushi i Operuar në SHBA.

e gjatë që ajo të ndihet e qetë në Amerikë.

“Prej se është larguar nga Kosova, ajo nuk është ndier e sigurt, edhe pse Spitali i Fëmijëve është njëri ndër më të mirët në botë. Ky është një instinkt i nënës që ajo kurrë nuk mund të jetë e sigurt deri sa nuk sheh diçka, deri pas operacionit”, thotë Rukaj.

Rruga e Endritit për të gjetur kujdes mjekësor ka qenë e rëndë. Bazuar në aplikimin për vizë hyrëse në SHBA, familja Zhushi jeton me rreth 140 euro në muaj. Kjo shumë është nga pensioni invalidor i babait të Endritit, Nysre-tit, i cili është plagosur gjatë luftës në Kosovë.

Së voni edhe një djalë tjetër nga Kosova kishte kryer një operacion me sukses dhe ai është mirëpritur nga një familje tjetër në Waltham.

Lidhja kryesore që dërgoi këta dy fëmijë në SHBA është kosovari Gani Abazi, i cili thotë se Kosova ka një nevojë të madhe për ndihmë.

“Unë mendoj se njerëzit në Dhuratë Jete bëjnë një punë të mrekullueshme. Ata hapin dyert për njerëzit e botës për t'i njoftuar ata me bujarinë e SHBA-së. Nëse këta fëmijë nuk do të bënin operacionin dhe do të rrinin në Kosovë, ata do të vdisnin”, thotë Abazi.

Rotary Club nga Natick kishte ndihmuar Endritin financiarisht me pesë mijë dollarë. Gerard thotë se pjesën tjetër të kostos, e cila ka siguruar operimin dhe të gjitha shërbimet para dhe pas operacionit, ka qenë e siguruar nga Spitali i Fëmijëve.

“Nuk jam shumë e sigurt se sa ka kushtuar, por besoj se është rreth 250 mijë dollarë”, thotë Gerard.

“Pas kalimit për më pak se një muaji në SHBA, të enjten Behrija me Endritin janë kthyer për në shtëpi. Por, Behrija do të ketë çka të tregojë atje për mirësinë e amerikanëve.

“Kur të kthehem në Kosovë, unë do t'u them njerëzve se sa mikpritës janë njerëzit në Amerikë dhe se sa mahnitëse është për ta që të ndihmojnë familjet si ne”, ka thënë Behrija. Ajo po ashtu ka pohuar se tashmë djali i saj ka përpara një jetë të re.

“Tani Endriti do të ketë jetë të shëndoshë sikurse fëmijët e tjerë në Kosovë. Kjo është ajo për të cilën kam shpresuar dhe jam lutur për shëndetin e tij”.